



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

337/20
29.07.2020

PSH.nr.337/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068 dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: Blerim Dina - Kryetar, Nuhi Paçarizi -Referues dhe Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas nenit 23 të Rregullores së Punës së OSHP-së, përkitazi me ankesën e parashtruar nga OE "Premium Bakery" Sh.p.k. - Prishtinë, kundër njoftimit mbi dhënien e kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me ushqim e pije për nxënësit e shkollave fillore në Komunën e Prizrenit nga niveli 0 deri 5" me nr. të prokurimit: 622-19-6978-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Kuvendi Komunal - Prizren, më datën 27.07.2020, mori këtë:

URDHËRESË

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit OE "Premium Bakery" Sh.p.k.- Prishtinë, kundër njoftimit mbi dhënien e kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me ushqim e pije për nxënësit e shkollave fillore në Komunën e Prizrenit nga niveli 0 deri 5" me nr. të prokurimit: 622-19-6978-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal-Prizren.

II. OBLIGOHET, Autoriteti Kontraktues /AK/ Kuvendi Komunal-Prizren që të zbatoj vendimin e OSHP-së me numër PSH.nr.948/19 dhe vendimin PSH.nr.181/20, përkitazi me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me ushqim e pije për nxënësit e shkollave fillore në Komunën e Prizrenit nga niveli 0 deri 5" me nr. të prokurimit: 622-19-6978-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal-Prizren.

III. URDHËROHET, autoriteti kontraktues /AK/ Kuvendi Komunal-Prizren që në afat prej 5 (pesë) ditësh kalendarike të njoftoj OSHP-në dhe OE "Premium Bakery" Sh.p.k.- Prishtinë, lidhur me zbatimin e vendimit të OSHP-së me numër PSH.nr.948/19 dhe vendimin PSH.nr.181/20, përkitazi me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me ushqim e pije për nxënësit e shkollave fillore në Komunën e Prizrenit nga niveli 0 deri 5" me nr. të prokurimit: 622-19-6978-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal-Prizren.

IV. Mos respektimi i kësaj urdhërese, brenda periudhës prej 5 ditë kalendarike, do ta detyroj Panelin Shqyrtues që të veproj konform nenit 131 të LPP-së, dhe njëkohësisht të kërkoj nga KRPP-ja, anulimin e licencës për menaxherin e prokurimit të AK-së Kuvendi Komunal-Prizren sipas nenit 25 paragrafi 8 dhe 9 të LPP-së.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "Premium Bakery" Sh.p.k.- Prishtinë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, të njëjtit operator ekonomik i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform pikës 6 të nenit 31 të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues "Premium Bakery" Sh.p.k.- Prishtinë", si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 29.05.2020 me nr. 337/20, kundër njoftimit mbi dhënien e kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me ushqim e pije për nxënësit e shkollave fillore në Komunën e Prizrenit nga niveli 0 deri 5" me nr. të prokurimit: 622-19-6978-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal-Prizren duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1,6,7,52,59, 72 dhe 108A të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe nenin 39 të RRUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 03.06.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 10.06.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në Pretendimi nr.1, Lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK ka bërë shkelje të nenit 1, 6, 7, 52, 59, 72 dhe 108 A të LPP-së dhe nenit 39 të RrUOPP, me arsyetimin se:

"Pretendimet e OE ankuese janë kundër njoftimit për dhënie të kontratës dhe njoftimin mbi eliminimin, po ashtu OE ankues pretendon se AK nuk e ka respektuar Vendimin e OSHP-së PSH 181/20 të dt.29.01.2020, duke u bazuar në shkresat e lëndës eksperti shqyrtues konstaton se AK me rastin e rivlerësimit të ofertave

konform Vendimin e OSHP-së PSH 181/20 të dt.29.01.2020, ka rivlerësuar ofertat dhe ka kërkuar sqarime nga OE i rekomanduar për kontratë lidhur me lidhshmërinë e emrit të “Devolli Group SH.P.K.” dhe “ABRAZEN L.L.C” dhe AK ka pranuar sqarimin nga OE i rekomanduar për kontratë duke dëshmuar se në vitin 2016 është bërë vetëm ndryshimi i emrit të kompanisë nga Devolli Group SH.P.K. në ABRAZEN L.L.C. Kompania është e njëjtë vetëm se me date 11.11.2016 është bërë ndryshim i emrit të biznesit. Në dëshminë zyrtare të ARBK-së shumë qartë shkruan se është po ai biznesi i regjistruar në vitin 02.03.2004 mirëpo në vitin 11.11.2016 është ndryshuar vetëm emri. Pra, testi i paraqitur lidhur me analizat e qumështit, në dosje të tenderit është i të njëjtës kompani. Gjithashtu, AK ka kërkuar nga OE që për mostrat e dorëzuara të qumështit të bëjë edhe njëherë analizën e vlerave ushqyese që t'i krahasojmë me ato të dosjes së tenderit. OE i rekomanduar për kontratë edhe njëherë i ka bërë analizat pranë Agjensionit të Veterinarisë dhe Ushqimit të Kosoves, përmes raportit nr.474-2 të datës 25.02.2020.

Përgjigje në Pretendimi nr.2, Lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK ka bërë shkelje të nenit 1, 6, 7, 52, 59, 72 dhe 108 A të LPP-së dhe nenit 39 të RrUOPP, me arsyetimin se:

Lidhur me pretendimet tjera të OE ankuese, eksperti shqyrtues konstaton se pretendimet janë të njëjta me pretendimet e trajtuara me raportin 181/20 dhe Vendimin e OSHP-së PSH 181/20 të dt.29.01.2020 andaj vlejné të njëjtat përgjigje si në raportin 181/20 gjegjësisht si vijon:

“AK Komuna e Prizrenit me rastin e zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit e në veçanti me rastin e vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve por edhe me rastin e ri-shqyrtimit të kërkesës sonë na eliminon nga ky aktivitet i prokurimit dhe duke rekomanduar për kontratë një OE të pa përgjegjshëm me çka ka vepruar në kundërshtim me parimet themelore të prokurimit publik. Lidhur me shqetësimet tona si palë me interes juridik dhe material e njoftojmë panelin shqyrtues me pretendimet tona si me poshtë: Komuna e Prizrenit si autoritet kontraktues ka qenë e detyruar të zbatoj vendimin e panelit shqyrtues ashtu siç është vendosur në vendimin e dt. 29 Jan 2020 me nr. 948/19. Komuna e Prizrenit nuk ka përfillë vendimin e OSHP të datës 29 Jan 2020 me nr. 948/19 me të cilën cek që AK me këtë rast ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së dhe neneve si më poshtë: Nenin 1, Nenin 6, Nenin7, Nenin 52, Nenin 59, Nenin 72 të LPP-së, Nenin 39 të RRUOPP-së. Edhe në këtë rast të shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim AK-Komuna e Prizrenit me po të njëjtat arsye na eliminon nga ky aktivitet i prokurimit dhe rekomandon për kontratë të njëjtin OE. Arsyet me të cilat AK mbështetet në vendimin e tij janë dhe atë se: Vlera ushqyese të mostrave nuk janë në pajtim me kërkesat e DT. Se nuk kemi ofruar autorizim nga prodhuesi për lëngje dhe qumësht. Çmimi i përgjithshëm kalon tri shifra pas pikës dhjetore, Ne nuk pajtohemi me vendimin e AK-së dhe e kundërshtojmë fuqishëm arsyet për të cilat i njëjti pretendon se ne nuk kemi plotësuar kërkesat e DT dhe NJK nga kjo shihet se AK fare nuk ka bërë ri-vlerësim e aq me pak rishqyrtim të kërkesës sepse prapë arsyet janë të njëjta dhe ka mos përfillje të vendimit të panelit shqyrtues. Pretendimet e AK lidhur me arsyet e eliminimit e konfirmojmë se AK nuk ka

vlerësuar konform DT dhe LPP sepse vlerësimi i ofertës sonë tek vlerat ushqyese është bërë në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së dhe besojmë se nga komisioni jo profesional AK qoftë qëllimshëm apo pa qëllim duke mos shiquar në tërësi dokumentacionin e ofruar në DT ne sqarojmë dhe ju njoftojmë se vlera ushqyese në analizat e dorëzuara nga Premium Bakery askund nuk ka vlerë 1706 KJ/335 gjë që komisioni e ka vendosur si vlerë tek krosani me xhem dredhëzë gjë që na bënë të vijnë në përfundim që komisioni ka qenë jo profesional në leximin e analizave.

Ne edhe një herë jemi detyruar të ri-përsëritim dhe sqarojmë lidhur me këto vlera ushqyese ku AK nuk mund të vlerësojë drejtë analizave të dorëzuara nga ana jonë.

Lidhur me këtë AK ka bërë vlerësim të gabuar edhe gjatë rivlerësimit dhe rishqyrtimit për OE të rekomanduar për kontratë dhe i cili nuk ka plotësuar këto vlera ushqyese pasi që në DT është kërkuar që realizohet të jenë me gram e jo me përqindje dhe kalkulimi është bërë gabim nga komisioni.” duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit të lëndës eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi i operatorit ekonomik ankues se AK e ka eliminuar edhe me arsyetimin se “Qmimi i përgjithshëm kalon tri shifra pas pikës dhjetore” duke u bazuar në Raportin e Rivlerësimit të Ofertave dhe Vendimin e AK të publikuar në platformën e E-prokurimit me rastin e rivlerësimit të cilit i është bashkangjitur edhe letra standarte për eliminim e OE ankues "Premium Bakery "Sh.p.k. nuk është potencuar nga AK arsyeja e eliminimit “Qmimi i përgjithshëm kalon tri shifra pas pikës dhjetore” siç pretendon OE ankues, andaj ky pretendim nuk është i bazuar.

Ndërsa lidhur me pretendimet tjera të cekura më lartë nga OE ankues, eksperti shqyrtues konstaton se të njëjtat janë trajtuar dhe vendosur me Vendimin e OSHP-së, PSH nr.948/19 të dt.29.01.2020, andaj eksperti shqyrtues konstaton se kemi të bëjmë me situatë “Res Judicata”.

Lidhur me pretendimin e OE ankuese se “AK ka bërë lëshim (gabim në Vlerësim) në rekomandim për OE të rekomanduar tek Analizat e qumështit ku këto analiza nuk janë të bëra nga një Laborator i Akredituar nga DAK gjegjësisht janë prezantuar analiza të Kompanisë Devolli që OE i rekomanduar nuk ka Kontratë as autorizim dhe analizat janë të vitit 2016. Ndërsa nga Kompania Abrazen ka vetëm deklaratë të prodhimit. I njëjti lëshim (Gabim) në vlerësim për OE të rekomanduar për kontratë dhe i cili për Lëngje nuk ka dorëzuar analiza nga laborator i akredituar në Kosovë “IKSHPK“ por nga një Laborator i pa autorizuar gjegjësisht i pa akredituar nga DAK në këtë rast Instituti Bujqësor dhe AK gjithashtu ka marrë për bazë deklarin e prodhimit të OE gjë që nuk përkon me udhëzimet dhe rregullat e DT. Duke i pasur parasysh gjitha këto gabime të komisionit ne si OE mendojmë që OE i rekomanduar për kontratë nuk i plotëson asnjë nga kriteret e cekura në DT tek pika ‘Kapaciteti teknik dhe profesional’. Duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit të lëndës eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi i OE ankuese **nuk është i bazuar** sepse AK më rastin e rivlerësimit të ofertave konform Vendimit të OSHP-së, PSH nr.948/19 të dt.29.01.2020 ka kërkuar sqarime nga OE i rekomanduar për kontratë "Eurofood Sh.p.k. & Xhelal Pireci & Cons eng sh.p.k." dhe nga të njëjtat ka pranuar

Vërtetimin e “ARBK-së” të lëshuar me datën 18.11.2016 me numër të protokollit nr.1727, me të cilin është konstatuar se biznesi “DEVOLLI GROUP” SHPK me numër të biznesit 70100453 është regjistruar me datën 02.03.2004 me adresë të biznesit në Pejë, ndërsa nga data 11.11.2016 është bërë ndryshimi i emërimit dhe kalon në këtë emërtim “ABRAZEN”L.L.C..

Ndërsa lidhur me pretendimin e OE ankuese rreth analizave të laboratorëve eksperti shqyrtues konstaton se të njëjtat janë trajtuar dhe vendosur me Vendimin e OSHP-së, PSH nr.948/19 të dt.29.01.2020, andaj eksperti shqyrtues konstaton se kemi të bëjmë me situatë “Res Judicata”.

Lidhur me pretendimin e OE ankuese se “Ne si OE kemi dorëzuar një ofertë të përgjegjshme konform kriterit për dhënie të kontratës tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të lirë duke plotësuar kërkesat e DT dhe NJK, AK Komuna e Prizrenit tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale ka kërkuar autorizim origjinal prej prodhuesit për kifle, lëngje dhe qumësht ndërsa si dëshmi është kërkuar dëshmi autorizimi. Ne në ofertën tonë kemi dorëzuar një kontratë të cilën e kemi me prodhuesin e lëngjeve dhe qumështin Abrazen dhe e cila kontratë është akoma në implementim dhe kontrata që ne posedojmë ka shtrirje më të gjerë ligjore se sa një autorizim por disponojmë po ashtu edhe autorizimet nga po i njëjti prodhues për këto dy produkte.

AK për të sqaruar këtë çështje ka mund të kërkojë nga ne informata sqaruese për të vërtetuar se kemi apo nuk kemi autorizim me çka AK nuk ka vepruar konform nenit 72 të LPP-së lidhur me nenin 39.8 të RRUOPP-se për të kërkuar sqarim lidhur me këtë kontratë apo autorizim sepse ne kemi një ofertë me çmim më të ulët dhe me qëllim të ruajtjes së parasë publike për të cilën AK është thirrur dhe i autorizuar sipas nenit 1 të LPP ka qenë i detyruar të veproj konform këtyre dispozitave. Për habi lidhur me këtë AK ka kërkuar sqarime dhe informacione shtesë nga OE tjerë pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit për çështjet të cilat i ka pas të pa qarta ndërsa lidhur me ofertën tonë nuk ka ndërmarrë asnjë veprim konform nenit 72 të LPP. Me këtë AK me rastin e vlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 7 të LPP-së Barazia në trajtim/jo diskriminim citat i nenit 7.1.” Autoriteti Kontraktues do të trajtoj OE në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë jo diskriminuese.

Po ashtu AK si arsye tjetër e eliminimit tonë ka gjetur që çmimi total i ofertës tonë kalon tri shifra pas presjes dhjetore, ne nuk kemi pas mundësi për të elaboruar këtë çështje pasi AK nuk ka kërkuar sqarim se si kemi ardhë deri te ky çmim. Produktet tona të kërkuara në DT janë shumë specifike dhe si të tilla çmimet janë jashtëzakonisht të ndieshme deri në 3 decimale. Duke pasur parasysh që çmimi total ka qenë rekapitullimi i përqindjeve të çmimeve specifike të secilit produkt dhe në fund ka qenë e pashmangshme mospërdorimi i 3 decimaleve pas presjes dhjetore dhe si e tillë do të duhej të merrej si devijim i vogël sipas nenit 18.3 të RRUOPP-se. Në të gjitha rastet kur totali i Kategorisë A të jetë numër me 2 decimalje pas presjes dhjetore por numër tek atëherë 50% e tij me doemos do të jep numër me 3 decimale pas presjes dhjetore. Paneli shqyrtues konstaton se te gjithë çmimet për njësi OE ankues i ka dhënë me dy shifra pas presjes dhjetore.

Nga AK kemi kërkuar qasje në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë dhe një qasje e tillë na është lejuar me dt.09.12.2019, gjatë shiqimit të dokumentacionit të ofertës së këtij OE kemi gjetur se analizat për vlerat ushqyese të dorëzuar nga ky OE janë të muajit mars 2019 ndërsa njoftimi për kontratë është bërë me dt.13.09.2019, për habi korrespondojnë përafërsisht me kërkesat e AK si në gramazhë dhe përqindje, është për të dyshuar se si ka mundësi që OE i rekomanduar për kontratë e ka ditë se për cilat produkte duhet të dorëzohen mostrat ku asnjë njoftim për kontratë nuk kemi pas në muajin mars për këtë aktivitet të prokurimit, nga kjo vijmë në përfundim se DT dhe ky aktivitet i prokurimit ka qenë i porositur dhe përgaditur për këtë OE "Euro Food", duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit të lëndës eksperti shqyrtues konstaton se pretendimet e njëjta janë trajtuar dhe vendosur me Vendimin e OSHP-së, PSH nr.948/19 të dt.29.01.2020, andaj eksperti shqyrtues konstaton se kemi të bëjmë me situatë "Res Judicata".

Lidhur me pretendimin e OE ankuese se Komisioni nuk e ka vërejtur se OE i rekomanduar për kontratë ka tejkaluar buxhetin e paraparë ku e gjithë vlera e ofruar nga ky OE tejkalon buxhetin për 107,040.00 Euro (Njëqind e shtatë mijë e dyzet euro), që ka përcaktuar AK në DT dhe NJPK, AK konform nenit 9 ka qenë i obliguar që të marr vendim për të shtuar mjetet nëse OE ka tejkaluar shumën e disponueshmërisë, një vendim të tillë ne nuk e kemi has-gjetur në dosjen e AK për këtë AP. Lidhur me këtë AK ka qenë i detyruar të shpall të pa përgjegjshëm OE të rekomanduar për kontratë ashtu siç parashihet përfundimi i aktivitetit të prokurimit sipas nenit 62.1.2 të LPP. Lidhur me OE të eliminuar ne pajtohemi me vlerësimin e AK dhe shtojmë se i njëjti analizat e vlerave ushqyese i ka bërë tek Instituti në Pejë i cili nuk është i akredituar për të bërë këto analiza të vlerave ushqyese." duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit të lëndës eksperti shqyrtues konstaton se pretendimet e njëjta janë trajtuar dhe vendosur me vendimin PSH nr.948/19 të dt.29.01.2020, andaj eksperti shqyrtues konstaton se kemi të bëjmë me situatë "Res Judicata".

Lidhur me pretendimin e OE ankuese se kanë dorëzuar ofertë me çmim më të ulët dhe me qëllim të ruajtjes së parasë publike AK është e thirrur dhe e autorizuar sipas nenit 1 dhe 6 të LPP të veproj konform këtyre dispozitave, bazuar ne faktet e lartë cekura eksperti shqyrtues konstaton se ky pretendim nuk është i bazuar sepse me paragrafin 1.1 te pikës 1 te nenit 60 të LPP-së thuhet: "Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët".

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të hudhet poshtë si e pa bazuar si dhe rekomandon që të mbetet ne fuqi vendimi i AK-së për dhënie të kontratës.

Autoriteti Kontraktues, me datën 10.06.2020 me anë të parashtresës, e ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datën 10.06.2020 me anë të parashtresës, e ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 27.07.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Premium Bakery" Sh.p.k. - Prishtinë, se AK ka bërë shkelje të nenit 1, 6, 7, 52, 59, 72 dhe 108 A të LPP-së dhe nenit 39 të RrUOPP, me arsyetimin se AK Komuna e Prizrenit me rastin e zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit e në veçanti me rastin e vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve por edhe me rastin e ri-shqyrtimit të kërkesës sonë na eliminon nga ky aktivitet i prokurimit dhe duke rekomanduar për kontratë një OE të pa përgjegjshëm me çka ka vepruar në kundërshtim me parimet themelore të prokurimit publik. Lidhur me shqetësimet tona si palë me interes juridik dhe material e njoftojmë panelin shqyrtues me pretendimet tona si me poshtë: Komuna e Prizrenit si autoritet kontraktues ka qenë e detyruar të zbatojë vendimin e panelit shqyrtues ashtu siç është vendosur në vendimin e dt. 29 Jan 2020 me nr. 948/19. Komuna e Prizrenit nuk ka përfillë vendimin e OSHP të datës 29 Jan 2020 me nr. 948/19 me të cilën cek që AK me këtë rast ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së dhe neneve si më poshtë: Nenin 1, Nenin 6, Nenin 7, Nenin 52, Nenin 59, Nenin 72 të LPP-së, Nenin 39 të RRUOPP-së. Edhe në këtë rast të shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim AK-Komuna e Prizrenit me po të njëjtat arsye na eliminon nga ky aktivitet i prokurimit dhe rekomandon për kontratë të njëjtin OE. Arsyet me të cilat AK mbështetet në vendimin e tij janë dhe atë se: Vlera ushqyese të mostrave nuk janë në pajtim me kërkesat e DT. Se nuk kemi ofruar autorizim nga prodhuesi për lëngje dhe qumësht. Çmimi i përgjithshëm kalon tri shifra pas pikës dhjetore, ne nuk pajtohemi me vendimin e AK-së dhe e kundërshtojmë fuqishëm arsyet për të cilat i njëjti pretendon se ne nuk kemi plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë nga kjo shihet se AK fare nuk ka bërë ri-vlerësim e aq më pak rishqyrtim të kërkesës sepse prapë arsyet janë të njëjta dhe ka mos përfillje të vendimit të panelit shqyrtues. Pretendimet e AK lidhur me arsyet e eliminimit e konfirmojmë se AK nuk ka vlerësuar konform dosjes së tenderit dhe LPP sepse vlerësimi i ofertës sonë tek vlerat ushqyese është bërë në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së dhe besojmë se nga komisioni jo profesional AK qoftë qëllimshëm apo pa qëllim duke mos shiquar në tërësi dokumentacionin e ofruar në dosje të tenderit ne sqarojmë dhe ju njoftojmë se vlera ushqyese në analizat e dorëzuara nga Premium Bakery askund nuk ka

vlerë 1706 KJ/335 gjë që komisioni e ka vendos si vlerë tek krosani me xhem dredhëzë gjë që na bënë të vijmë në përfundim që komisioni ka qenë jo profesional në leximin e analizave. Ne edhe një herë jemi detyruar të ri-përsëritim dhe sqarojmë lidhur me këto vlera ushqyese ku AK nuk mund të vlerësoj drejtë analizave të dorëzuara nga ana jonë.

Paneli Shqyrtues sqaron se lidhur me pretendimin e OE ankues që ka të bëjë me vlera ushqyese të mostrave sipas kërkesës së dosjes së tenderit, kjo çështje është res judicata për shkak se lidhur me këtë pikë të pretendimit është vendosur në vendimin PSH.nr.181/20, ku në këtë vendim është sqaruar: “OE ankues ka dorëzuar raportet e testimit nga laborator “Akiment – Omnilab” ATD & “V Consult LTD” të datës 24-25.10.2019 në të cilat janë përshkruar vlerat ushqyese të kifleve, qumështit dhe lëngjeve e që bazuar në këto raporte konstatohet se OE ankues ka ofertuar me mallëra kifile të cilat tejkalojnë vlerën referente, respektivisht kushtin e vendosur nga AK në aneksin 1 të dosjes së tenderit...”. Pra, kjo pikë e pretendimit është e pa bazuar. Sa i përket pikës tjetër të pretendimit që ka të bëjë me autorizimin nga prodhuesi për lëngje dhe qumësht, Paneli Shqyrtues sqaron se e njëjta situatë është edhe me këtë pretendim sepse kjo çështje konsiderohet “res judicata” për shkak se për këtë pretendim Paneli Shqyrtues kishte sqaruar se OE ankues nuk kishte dorëzuar autorizim origjinal të prodhuesit për kifile, qumësht dhe lëngje siç e ka kërkuar AK me njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit por ka dorëzuar vetëm një kontratë shitblerje për qumësht dhe lëngje me prodhuesin “Abrazen”, fakt të cilin e ka vërtetuar edhe vetë OE ankuese në njëërën prej deklaratave të ankesave të parashtruar në OSHP. Pra, edhe kjo pikë ankimore është e pa bazuar. Ndërsa, lidhur me pikën tjetër të pretendimit që ka të bëjë me çmimin e përgjithshëm që i kalon tri shifra pas pikës dhjetore, Paneli Shqyrtues sqaron se edhe kjo çështje është “res judicata”, megjithatë AK në vlerësimin e fundit nuk ka konstatuar apo potencuar se oferta e OE ankues kalon tri shifra pas pikës dhjetore.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Premium Bakery" Sh.p.k. - Prishtinë se AK ka bërë lëshim (gabim në vlerësim) në rekomandim për OE të rekomanduar tek Analizat e qumështit ku këto analiza nuk janë të bëra nga një Laborator i Akredituar nga DAK gjegjësisht janë prezantuar analiza të kompanisë Devolli që OE i rekomanduar nuk ka Kontratë as autorizim dhe analizat janë të vitit 2016. Ndërsa nga Kompania Abrazen ka vetëm deklaratë të prodhimit. I njëjti lëshim (gabim) në vlerësim për OE të rekomanduar për kontratë dhe i cili për lëngje nuk ka dorëzuar analiza nga laborator i akredituar në Kosovë “IKSHPK” por nga një laborator i pa autorizuar gjegjësisht i pa akredituar nga DAK në këtë rast Instituti Bujqësor dhe AK gjithashtu ka marr për bazë deklarin e prodhimit të OE gjë që nuk përkon me udhëzimet dhe rregullat e dosjes së tenderit. Duke i pasur parasysh gjitha këto gabime të komisionit ne si OE mendojmë që OE i rekomanduar për kontratë nuk i plotëson asnjë nga kriteret e cekura në dosje të tenderit tek pika “Kapaciteti teknik dhe profesional”.

Paneli Shqyrtues sqaron se për këtë pretendim ankimor ka dhënë sqarime në vendimin e mëhershëm, andaj kjo çështje konsiderohet “res judicata”. Megjithatë, ky pretendim ankimor është i bazuar për shkak se në vendimin

e mëhershëm, Paneli Shqyrtues ka sqaruar: "...OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar Raportet e analizës së qumështit të lëshuara me datën 25.01.2016, nga Qendra e laboratorit testues IKSHPK-DAK për kompaninë "SHPK Devolli Group" por nuk ka bashkangjitur asnjë kontratë apo marrëveshje që ndërlidhë ndonjërin nga OE anëtare të konzorciumit të rekomanduar për kontratë me kompaninë "SHPK Devolli Group" andaj bazuar në këtë fakt konstatohet se grupi i OE-ve të rekomanduar për kontratë nuk ka dorëzuar Raporte të testimi nga laboratorët e certifikuar për vlerat ushqyese të Qumështit sipas kërkesave të parashtruara nga autoriteti kontraktues në dosjen tenderit". Pra, ky pretendim është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Premium Bakery" Sh.p.k. – Prishtinë se "ne si OE kemi dorëzuar një ofertë të përgjegjshme konform kriterit për dhënie të kontratës tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të lirë duke plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, AK Komuna e Prizrenit tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale ka kërkuar autorizim origjinal prej prodhuesit për kiflet, lëngje dhe qumësht ndërsa si dëshmi është kërkuar dëshmi autorizimi. Ne në ofertën tonë kemi dorëzuar një kontratë të cilën e kemi me prodhuesin e lëngjeve dhe qumështin Abrazen dhe e cila kontratë është akoma në implementim dhe kontrata që ne posedojmë ka shtrirje më të gjerë ligjore se sa një autorizim por disponojmë po ashtu edhe autorizimet nga po i njëjti prodhues për këto dy produkte. AK për të sqaruar këtë çështje ka mund të kërkojë nga ne informata sqaruese për të vërtetuar se kemi apo nuk kemi autorizim me çka AK nuk ka vepruar konform nenit 72 të LPP-së lidhur me nenin 39.8 të RRUOPP-se për të kërkuar sqarim lidhur me këtë kontratë apo autorizim sepse ne kemi një ofertë me çmim më të ulët dhe me qëllim të ruajtjes së parashës publike për të cilën AK është thirrur dhe i autorizuar sipas nenit 1 të LPP ka qenë i detyruar të veprojë konform këtyre dispozitave. Për habi lidhur me këtë AK ka kërkuar sqarime dhe informacione shtesë nga OE tjerë pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit për çështjet të cilat i ka pas të pa qarta ndërsa lidhur me ofertën tonë nuk ka ndërmarrë asnjë veprim konform nenit 72 të LPP. Me këtë AK me rastin e vlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 7 të LPP-së Barazia në trajtim/jo diskriminim citat i nenit 7.1." Autoriteti Kontraktues do të trajtojë OE në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë jo diskriminuese. Po ashtu, AK si arsye tjetër e eliminimit tonë ka gjetur që çmimi total i ofertës tonë kalon tri shifra pas presjes dhjetore, ne nuk kemi pas mundësi për të elaboruar këtë çështje pasi AK nuk ka kërkuar sqarim se si kemi ardhë deri te ky çmim. Produktet tona të kërkuara në dosje të tenderit janë shumë specifike dhe si të tilla çmimet janë jashtëzakonisht të ndieshme deri në 3 decimale. Duke pasur parasysh që çmimi total ka qenë rekapitullimi i përqindjeve të çmimeve specifike të secilit produkt dhe në fund ka qenë e pashmangshme mospërdorimi i 3 decimaleve pas presjes dhjetore dhe si e tillë do të duhej të merrej si devijim i vogël sipas nenit 18.3 të RRUOPP-se. Në të gjitha rastet kur totali i Kategorisë A të jetë numër me 2 decimale pas presjes dhjetore por numër tek atëherë 50% e tij me doemos do të jep numër me 3 decimale pas presjes dhjetore. Nga AK kemi kërkuar qasje në ofertën e OE të

rekomanduar për kontratë dhe një qasje e tillë na është lejuar me dt.09.12.2019, gjatë shikimit të dokumentacionit të ofertës së këtij OE kemi gjetur se analizat për vlerat ushqyese të dorëzuar nga ky OE janë të muajit mars 2019 ndërsa njoftimi për kontratë është bërë me dt.13.09.2019, për habi korrespondojnë për afërsisht me kërkesat e AK si në gramazhë dhe përqindje, është për të dyshuar se si ka mundësi që OE i rekomanduar për kontratë e ka ditë se për cilat produkte duhet të dorëzohen mostrat ku asnjë njoftim për kontratë nuk kemi pas në muajin mars për këtë aktivitet të prokurimit, nga kjo vijmë në përfundim se dosja e tenderit dhe ky aktivitet i prokurimit ka qenë i porositur dhe përgatitur për këtë OE "Euro Food".

Paneli Shqyrtues sqaron se për pretendimin që ka të bëjë me autorizimin nga prodhuesi dhe pretendimin që ka të bëjë me tre numra pas presjes dhjetore, më lartë janë dhënë sqarime për secilën prej këtyre pikave ankimore. Kurse, sa i përket pretendimit që ka të bëjë me dyshimin për se analizat për vlerat ushqyese të dorëzuar nga OE i rekomanduar janë të muajit mars 2019, ndërsa njoftimi për kontratë është bërë me dt.13.09.2019 dhe për habi korrespondojnë për afërsisht me kërkesat e AK si në gramazhë dhe përqindje, Paneli Shqyrtues sqaron se këtë dyshim të OE ankues nuk mund ta vërtetojë e as të konstatojë për shkak se është e pa mundur që konstatimi eventual të bazohet në ndonjë fakt.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Premium Bakery" Sh.p.k. – Prishtinë se komisioni nuk e ka vërejtur se OE i rekomanduar për kontratë ka tejkaluar buxhetin e paraparë ku e gjithë vlera e ofruar nga ky OE tejkalon buxhetin për 107,040.00 Euro (Njëqind e shtatë mijë e dyzet euro), që ka përcaktuar AK në dosje të tenderit dhe NJPK, AK konform nenit 9 ka qenë i obliguar që të marr vendim për të shtuar mjetet nëse OE ka tejkaluar shumën e disponueshmërisë, një vendim të tillë ne nuk e kemi has-gjetur në dosjen e AK për këtë AP. Lidhur me këtë AK ka qenë i detyruar të shpall të pa përgjegjshëm OE të rekomanduar për kontratë ashtu siç parashihet përfundimi i aktivitetit të prokurimit sipas nenit 62.1.2 të LPP. Lidhur me OE të eliminuar ne pajtohemi me vlerësimin e AK dhe shtojmë se i njëjti analizat e vlerave ushqyese i ka bërë tek Instituti në Pejë i cili nuk është i akredituar për të bërë këto analiza të vlerave ushqyese". Paneli Shqyrtues sqaron se kjo çështje është "res judicata", ku për më shumë i referoheni vendimit të mëhershëm.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Premium Bakery" Sh.p.k. – Prishtinë se kanë dorëzuar ofertë me çmim më të ulët dhe me qëllim të ruajtjes së parasë publike AK është e thirrur dhe e autorizuar sipas nenit 1 dhe 6 të LPP të veprojnë konform këtyre dispozitave.

Paneli Shqyrtues sqaron se ky pretendim ankimor është i pa bazuar për shkak se në paragrafin 1.1 të pikës 1 të nenit 60 të LPP-së është përcaktuar që autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët, ndërsa në rastin konkret AK e ka trajtuar si ofertë të papërgjegjshme tenderin e OE ankues.

Paneli Shqyrtues duke e pasur parasysh ecurinë e këtij aktiviteti të prokurimit, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues e ka bërë ekzaminimin e tenderëve në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në dosje të tenderit dhe njoftimit për kontratë, me çka ka rezultuar se AK njëkohësisht ka bërë vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve në kundërshtim edhe me nenin 59 të LPP-së. Andaj, urdhërohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave të veproj në pajtim me kërkesat e dosjes së tenderit dhe të bëjë vlerësimin e tenderëve në pajtim me nenin 59 të LPP-së, si dhe ti merr parasysh edhe sqarimet të cilat janë bërë në vendimet paraprahe për këtë çështje.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Urdhëresa t'i dorëzohet:

1x1 AK- Kuvendi Komunal- Prizren

1x1 OE ankues - Premium Bakery Sh.p.k

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Blerim Dina

